



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.14, datë.29.05.2024

**PËR**  
**MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN:**  
**“KOMPLEKS GODINASH SHËRBIMI DHE BANIMI 2, 6, 9, 12, 13 KATE**  
**MBITOKË ME 2 KATE PARKIMI NËNTOKË”, ME VENDNDODHJE NË RRUGËN**  
**“NIKOLLA ZORAQI”, BASHKIA TIRANË**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “5 Star Construction” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e lejes së zhvillimit për objektin: “Kompleks godinash shërbimi dhe banimi 2, 6, 9, 12, 13 kate mbitokë me 2 kate parkimi nëntokë”, me vendndodhje në Rrugën “Nikolla Zoraqi”, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “5 Star Construction” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë bashkëlidhen si pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS  
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT  
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT  
ADELAJDA ROKA

Nënshkruar më datë 21 / 11 / 2024